



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

Fjala e Rektorit në themelimin e Bordit Këshillëdhënës Industrial të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan

Gjiilan, më 29 Maj 2018

Me themelimin e Bordit Këshillëdhënës Industrial (BKI) UKZ po synon ta ndërlidhë sa më shumë UKZ dhe akademizmin me bashkësinë.

Një nga objektivat më të rëndësishme për Bordin Këshillëdhënës Industrial (BKI) është të kontribuojë në suksesin strategjik të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe të programeve studimore të fakulteteve të tij.

BKI fokusohet në aspektet e marrëdhënies së mësimi akademik dhe tregut të punës, pra në ndërlidhjen sa më të mirë të programeve studimore me biznesin dhe industrinë.

BKI do të trajtojë çështje të tilla si:

- 1) Përcaktimi i hapave që kërkohen për të përmirësuar dhe zgjeruar marrëdhëniet aktuale të programeve studimore të UKZ me biznesin dhe industrinë dhe si ta përmirësojë atë.
- 2) Ndhma që programet studimore të UKZ, vetë UKZ, të ndërtojë një imazh më të mirë dhe njohje Rajonin e Anamoravës e të Gollakut, në Kosovën Lindore dhe në Maqedoninë Veriore, si dhe më gjerë, në Kosovë e në rajon.
- 3) Ndërlidhjen e perspektivës industriale në programet universitare.
- 4) Vlerësimi i nivelit të kompetencave të të diplomuarve të programeve studimore të UKZ dhe ofrimi i kontributit në përmirësimin e kursit dhe kurrikulës në drejtim të perspektivës industriale.
- 5) Ndhma e programeve studimore të UKZ për të tërhequr grante kërkimore, projekte të dizajnuara nga studentët, organizimin e praktikës së studentëve etj.

Takimet e Bordit Këshillëdhënës Industrial do të jenë vjetore.

Ftohen dekanët e fakulteteve që të zhvillojnë programe bashkëpunimi konkret me anëtarët e BKI në realizimin e synimeve të përbashkëta.